



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Veçante



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201401004/2

Tiranë ___/___/2014

Lënda: *Rekomandojmë të shikohet mundësia e shpejtimin të procedurës së gjyimit të kërkesës së të shtetasit Q. X., me objekt shuarjen e masës sigurimit në bazë të neneve 260 e vijues të K.Pr.Penale.*

Drejtuar : **Z. Petrit ÇENO**
Kryetar i Gjykatës së Apelit

DURRËS

Për dijëni : **Zj.Marsida XHAFERLLARI**
K/Inspektorese së KLD-së

TIRANË

I nderuar Z. Kryetar,

Në ankesën e saj datë 13.05.2014 drejtuar institucionit të Avokatit të Popullit, shtetësja V. Xh. nga qyteti i Elbasanit ankohet për zvarritje gjykimi dhe shkeljen e procedurave gjyqësore nga Gjykata e Apelit Durrës në shqyrtimin e një kërkesë të djalit saj të gjykuarit Q. Xh. me objekt shuarjen e masës sigurimit me arrest në burg për shkak të kalimit të afateve të paraburgimit në bazë të neneve 260 e vijues të K.Pr.Penale.

Nga studimi i akteve përkatëse dhe i vendimeve gjyqësore, rezultoi se :

Me vendimin Nr.38 datë 27.01.2011 të Gjykatës Rrethit Gjyqësor Elbasan është vendosur vlerësimi i ligjshëm i arrestit në flagrancë të shtetasit Q. Xh. dhe ndaj tij gjykata ka caktuar si masë sigurimi arrest me burg pa afat në bazë të nenit 238 të K.Pr.Penale.

Me vendimin penal Nr.353 datë 12.06.2012 të Gjykatës Rrethit Gjyqësor Elbasan është vendosur deklarimi fajtor i të pandehurit Q. Xh. dhe në bazë të nenit 283/2 i K.Penal e ka dënuar me 8 vjet burgim. Ndaj këtij vendimi është bërë ankim nga i pandehuri Q. Xh. dhe Gjykata e Apelit Durrës me vendimin e saj Nr.53 datë 24.01.2013 ka vendosur prishjen e vendimit Nr.353 datë 12.06.2012 të Gjykatës Rrethit Gjyqësor Elbasan dhe kthimin e çështjes për rigjykim në po atë gjykatë me tjetër trup gjykues.

Ndaj këtij vendimi gjyqësor ka ushtruar rekurs Prokurori i Apelit pranë Gjykatës së Apelit Durrës, dhe Gjykata e Lartë me vendimin Nr.46 datë

18.02.2014 ka vendosur : prishjen e vendimit Nr.53 datë 24.01.2013 të Gjykatës së Apelit Durrës dhe kthimin e çështjes për rigjykim në po atë gjykatë me tjetër trup gjykues.

Me datën 12.03.2014 kërkuesi Q. Xh. i ka drejtuar kërkesën për shuarjen e masës sigurimit Gjykatës Rrethit Gjyqësor Elbasan e cila me vendimin e saj Nr.307 datë 15.04.2014 ka vendosur shpalljen e moskompetencës së Gjykatës Rrethit Gjyqësor Elbasan dhe dërgimin e kërkesës dhe të akteve për shqyrtim Gjykatës Apelit Durrës.

Nga dokumentat e paraqitura tek ne dhe aktet përkatëse del se të gjykuari Q. Xh. kanë kaluar afatet e paraburgimit të parashikuara nga neni 263/6/c të K.Pr.Penal dhe për rrjedhim ai mbahet në burg me masën e sigurimit me arrest në burg në kundësthim me ligjin. Kjo shkelje ligji përbën shkelje të rëndë mbi të Drejtat dhe liritë themelore të Njeriut, dhe duke analizuar në tërësi rrethanat e kësaj çështje menduam t'ju ndërhyjmë ju me rekomandim për shpejtimin e procedurave gjyqësore të gjyqimit të kësaj çështje të veçantë. Afati i paraburgimit të gjykuarit Q. Xh. ka përfunduar me datën 21.01.2014. Ky pretendim i ankueses bazohet në kërkesën për shuarjen e masës sigurimit të gjykuarit Q. Xh. si dhe në kërkesat e neneve 260 e vijues të K.Pr.Penale.

Kështu në nenin 263/6/c të K.Pr>Penale parashikohet se:”**Kohëzgjatja tërësore e paraburgimit duke marrë parasysh edhe zgjatjet e parashikuara nga neni 264/2 të këtij kodi, nuk mund të kalojë këto afate, pika c) tre vjet kur procedohet për krime që dënohen në minimum jo më pak se 10 vjet burgim ose me burgim të përjetshëm.** Ndërsa në nenin 260/4 të KPrPenale, thuhet se:” **Kerkesa e prokurorit ose e të pandehurit shqyrtohet nga gjykata brenda 5 ditëve nga depozitimi i saj”.**

E drejta për tu gjykuar para një gjykate kompetente të pavarur dhe të paanshme të caktuar me ligj kërkon që drejtësia jo vetëm duhet të bëhet por ajo duhet të shihet se po bëhet. Në nenin 42/2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, parashikohet e drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publikë dhe brenda një afati të arsyeshëm.

Në nenin 63 pika 3 të Kushtetutës së RSH, parashikohet se:”**Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave të Njeriut, nga administrata publike**”, dhe në nenin 25 të Ligjit nr.8454 datë 04.02.1999”Për Avokatin e Popullit”, ku përcaktohet shprehimisht se:”**Avokati i Popullit pranon ankesa, kërkesa apo njoftime për shkeljen e të drejtave të Njeriut, që rrjedhin nga administrata e pushtetit gjyqësor, vendimet e formës së prerë dhe procedurat gjyqësore**”. **Hetimi dhe kërkesa e Avokatit të Popullit nuk prekin pavarësinë e gjykatës në marrjen e vendimit.**

Për sa sipër, Ju

REKOMANDOJMË :

1.Të shikohet mundësia e shpejtimin të procedurave gjyqësore të kërkesës së shtetasit Q. Xh., me objekt shuarjen e masës sigurimit.

2.Mbi shqyrtimin e këtij rekomandimi dhe masat e marra, lutemi në bazë të nenit 22 të Ligjit nr.8454 datë 04.02.1999”Për Avokatin e Popullit”, të njoftohemi me shkrim brenda afatit 30 ditor.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj.

KOMISIONERI

Arben SHKËMBI